LIGJ
Nr. 144/2013
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1/c paragrafi i parë, pas fjalëve "të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit," shtohen fjalët "të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve,".

Neni 2

Në nenin 32, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
"Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet.

Neni 3

Në nenin 34, paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:
"Për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ose, në mungesë të tyre, dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.".

Neni 4

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:
"Neni 39
Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie
Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie e ndalon të dënuarin të ushtrojë profesionin ose veprimtarinë, për të cilën është dhënë leje e veçantë, dëshmi, autorizim apo licencë nga organi kompetent.
Heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni jepet për një kohë nga një muaj deri në pesë vjet dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen duke i shpërdoruar ato, ose kur vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë apo profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete."

KeshillimeLigjore.AL

Neni 5

Në nenin 48 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën "a" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën "j" të nenit 50 të këtij Kodi.

Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën "e" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.".

Neni 6

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

a) Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "ç/1" me këtë përmbajtje:

"ç/1) kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike;".

b) Pas shkronjës "e" shtohet shkronja "e/1" me këtë përmbajtje:

"e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;".

c) Shkronja "g" ndryshohet si më poshtë:

"g) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes;".

ç) Shkronja "j" ndryshohet si më poshtë:

"j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.".

Neni 7

Pas nenit 52 shtohet neni 52/a me këtë përmbajtje:

"Neni 52/a

Përjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat

Personi, që ka premtuar ose ka dhënë shpërblim ose përfitime të tjera, sipas neneve 164/a, 244, 244/a, 245, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c dhe 328 të këtij Kodi mund të përfitojë përjashtim nga vuajtja e dënimit ose ulje të tij, nëse bën kallëzim dhe jep ndihmesë në procedimin penal të këtyre veprave. Në dhënien e vendimit, gjykata mban parasysh edhe kohën kur është bërë kallëzimi, ardhjen ose jo të pasojave të veprës.

Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.

Personi që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi.". 3528

Neni 8

Në nenin 53, pas fjalëve "rrethanave lehtësuese" shtohen fjalët "dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese".

Neni 9

Në nenin 55, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.

Neni 10

Në nenin 59/a, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Gjykata, në rrethanat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi, të dënuarve që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij.".

Neni 11

Pas nenit 60 shtohet neni 60/a me këtë përmbajtje:
"Neni 60/a
Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës
Gjykata, ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike, vendos detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës.
Trajtimi mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës bëhet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, në bazë të kërkesës së shërbimit të provës.
Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimin e vendosur.".

Neni 12

Në nenin 64, në fund të paragrafit të tretë shtohen fjalët "si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.".

Neni 13

Neni 74 ndryshohet si më poshtë:
"Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllevër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.".

Neni 14

Në nenin 78, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
"Vrasja e kryer për interes apo hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.".

Neni 15

Pas nenit 78 shtohet neni 78/a me këtë përmbajtje:
"Neni 78/a
Vrasja për gjakmarrje
Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.".

Neni 16

Pas nenit 79 shtohen nenet 79/a, 79/b dhe 79/c me këtë përmbajtje:
"Neni 79/a
Vrasja e funksionarëve publikë
Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.
Neni 79/b
Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit
Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.
Neni 79/c
Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare
Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.".

Neni 17

Në nenin 81, fjalët "përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet" zëvendësohen me fjalët "dënohet me burgim deri në pesë vjet".

Neni 18

Në nenin 88, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
"Po kjo vepër, kur është kryer kundër disa personave, kundër personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet."

Neni 19

Në nenin 99, fjalët "në vartësi materiale apo çfarëdolloj vartësie tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet" zëvendësohen me fjalët "në varësi apo nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet".

Neni 20

Në nenin 100 bëhen këto ndryshime:
a) Në paragrafin e dytë fjalët "dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet" zëvendësohen me fjalët "dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet".
b) Në paragrafin e tretë fjalët "dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet" zëvendësohen me fjalët "dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm".

Neni 21

Në nenin 102, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.".

Neni 22

Pas nenit 107 shtohet neni 107/a me këtë përmbajtje:

"Neni 107/a

Dhuna seksuale

Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.".

Neni 23

Në nenin 108, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.".

Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjërës nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.".

Neni 24

Pas nenit 108 shtohet neni 108/a me këtë përmbajtje:

"Neni 108/a

Ngacmimi seksual

Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.".

Neni 25

Pas nenit 109/b shtohet neni 109/c me këtë përmbajtje:

"Neni 109/c

Zhdukja me forcë
Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
Eprori që:
a) ka dijeni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryejnë ose do të kryejnë zhdukje me forcë, ose nuk merr parasysh të dhëna dhe informacione që e tregojnë qartë këtë fakt;
b) ushtron përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat është lidhur zhdukja me forcë; apo
c) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që janë në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar personin që jep autorizimin, mbështetjen dhe miratimin e zhdukjes me forcë, ose për t'ia dërguar çështjen organeve kompetente të ndjekjes penale, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.
Kur kjo vepër kryhet kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen, apo shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen e personit, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.
Marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Neni 26

Në nenin 110/a bëhen këto ndryshime:
a) Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:
“Trafikimi i personave të rritur”
b) Në paragrafin e parë fjalët “dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë” zëvendësohen me fjalët “si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.
c) Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.
ç) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:
“Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 27

Pas nenit 110/a shtohen nenet 110/b dhe 110/c me këtë përmbajtje:
“Neni 110/b

Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar
nga personat e trafikuar
Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.
Neni 110/c
Veprimet që lehtësojnë trafikimin
Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.
Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.”.

Neni 28

Neni 114 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 114
Shfrytëzimi i prostitucionit
Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 29

Neni 117 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 117
Pornografia
Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet.
Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.
Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.
Neni 30
Në nenin 124/b, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
“Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”.

Neni 31

Në nenin 128/b paragrafi i parë, fjalët "dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë" zëvendësohen me fjalët "dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet".

Neni 32

Neni 130 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 130

Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë

Shtrëngimi apo pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrëngimi për të lidhur apo zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.".

Neni 33

Në nenin 130/a, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.".

Neni 34

Pas nenit 137 shtohet neni 137/a me këtë përmbajtje:

"Neni 137/a

Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike

Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.".

Neni 35

Pas nenit 144 shtohet neni 144/a me këtë përmbajtje:

"Neni 144/a

Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar

Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese, me qëllim fitimin material për vete apo për të tjerët, nëpërmjet mospagimit, apo përfitimit të kreditimit ose rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.".

Neni 36

Neni 180 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 180

Fshehja e të ardhurave

"Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim

fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.”.

Neni 37

Pas nenit 182 shtohet neni 182/a me këtë përmbajtje:
“Neni 182/a
Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare
Prishja me dashje e shenjave dalluese të vendosura nga administrata tatimore për bllokimin apo pezullimin e veprimtarisë tregtare, apo ushtrimi i veprimtarisë tregtare pas njoftimit të vendimit të administratës tatimore për bllokimin apo pezullimin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.”.

Neni 38

Në nenin 206/a bëhen këto ndryshime:
a) Në paragrafin e parë, fjalët “nga tre deri në pesë vjet dhe me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë” zëvendësohen me fjalët “nga pesë deri në tetë vjet”.
b) Në paragrafin e dytë, fjalët “nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë” zëvendësohen me fjalët “nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.
c) Në paragrafin e tretë, fjalët “nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë” zëvendësohen me fjalët “nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

Neni 39

Në nenin 206/b bëhen këto ndryshime:
a) Në paragrafin e parë, fjalët “nga një deri në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “nga dy deri në pesë vjet”.
b) Në paragrafin e dytë, fjalët “nga dy deri në pesë vjet” zëvendësohen me fjalët “nga tre deri në tetë vjet”.

Neni 40

Në nenin 253, pas fjalës “seksi” shtohen fjalët “orientimi seksual ose identiteti gjinor”.

Neni 41

Neni 265 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 265
Nxitja e urrejtjes ose grindjeve
Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.”.

Neni 42

Në nenin 266, fjalët “me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet” zëvendësohen me fjalët “dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”.

Neni 43

Neni 278 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 278
Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit
Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
Mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.
Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”.

Neni 44

Në nenin 278/a, pas fjalëve “i armëve dhe municionit luftarak,” shtohen fjalët “ose i pjesëve përbërëse të tyre.”.

Neni 45

Neni 279 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 279
Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta
Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja, e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
Mbajtja, blerja apo shitja në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.”.

Neni 46

Neni 290 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 290
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.”.

Neni 47

Neni 291 ndryshohet si më poshtë:
“Neni 291
Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt
Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike, apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë, dënohet me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 48

Shfuqizime

1. Neni 79 shkronja “c”, nenet 114/a, 114/ b, 245/2 dhe 284/b shfuqizohen.
2. Në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 124/a, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 197/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331, pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet.

Neni 49

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 2.5.2013
Shpallur me dekretin nr. 8176, datë 14.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani